

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-PT

Data: 14 dhjetor 2010

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie,

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 14 dhjetor 2010

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM PËRMBLEDHËS MBI MOCIONET E MBROJTJES PËR ZGJATJE
AFATI DHE MBI MOCIONIN E RAMUSH HARADINAJT NË LIDHJE ME
PËRCAKTIMIN E KUADRIT TË RIGJYKIMIT TË PJESSHËM**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të Mbrojtjes:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Kërkesë e Idriz Balajt për Kohë Shtesë për Paraqitjen e Dosjes së tij Paragjyqësore, dorëzuar më 7 dhjetor 2010 (“Mocion i Balajt për Zgjatje Afati”),¹ “Mocion në Emër të Ramush Haradinajt për Zgjatje Afati për Paraqitjen e Dosjes Paragjyqësore të Mbrojtjes”, dorëzuar konfidencialisht më 8 dhjetor 2010 (“Mocioni i Haradinajt për Zgjatje Afati”) dhe “Kërkesë e Lahi Brahimaajt për Zgjatje Afati për Paraqitjen e Dosjes së tij Paragjyqësore”, dorëzuar më 8 dhjetor 2010 (“Mocion i Brahimaajt për Zgjatje Afati”) (së bashku “Mocione të Mbrojtjes për Zgjatje Afati”); dhe “Mocion në Emër të Ramush Haradinajt për Përcaktimin e Kuadrit të Rigjykit të Pjesshëm”, dorëzuar konfidencialisht më 8 dhjetor 2010 (“Mocion i Haradinajt mbi Përcaktimin e Kuadrit”).

A. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 21 korrik 2010 Dhoma e Apelit konkludoi se mosmarrja prej Dhomës Gjyqësore e masave të nevojshme kundër frikësimit të dëshmitarëve që përshkoi procesin gjyqësor, dhe në veçanti mostrajtimi i kërkesave të Prokurorisë për marrjen e dëshmisë prej Kabashit dhe dëshmitarit tjetër rezultuan në dështim të drejtësisë.² Rrjedhimisht Dhoma e Apelit shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore për dhënien e pafajësisë Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimaajt për disa pika të Aktakuzës dhe urdhëroi rigjykim të pjesshëm.³

2. Në Konferencën mbi Gjendjen mbajtur më 23 shtator 2010, Gjykatësi Paragjyqësor urdhëroi Prokurorinë që brenda 30 nëntorit 2010 të dorëzonte Dosjen Paragjyqësore së bashku me listën e dëshmitarëve të saj dhe të provave materiale bazuar në Rregullën 65 *ter* të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”)⁴ dhe urdhëroi Mbrojtjen të dorëzonte Dosjen Paragjyqësore brenda 14 dhjetorit 2010.⁵

¹ Mocioni i Balajt për Zgjatje Afati u dorëzua publikisht më 7 dhjetor 2010. Më 8 dhjetor 2010 Balaj dorëzoi “Njoftim dhe Kërkesë për Ndryshimin e Statusit të Kërkesës së Idriz Balajt për Kohë Shtesë për Paraqitjen e Dosjes Paragjyqësore”, ku ai i kërkoi Sekretarisë ta ricilësonte Mocionin si konfidencial.

² Aktgjykimi i Apelit, para 37, 49.

³ *Po aty*, para. 377.

⁴ Konferencë mbi Gjendjen, T.6 (23 shtator 2010).

⁵ *Po aty*, T. 23-24 (23 shtator 2010)

3. Në “Parashtrim i Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar”, dorëzuar më 9 nëntor 2010, Prokuroria paraqiti versionet “e shënuara” dhe të “pastra” të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt që korrespondojnë me lëndën e rigjykimit të pjesshëm (“Aktakuzë e shkurtuar”).

4. Më 23 nëntor 2010 Ramush Haradinaj dorëzoi “Parashtrim në Emër të Ramush Haradinajt mbi Versionin e Ri të Aktakuzës për Rigjykimin e Pjesshëm”; Idriz Balaj dorëzoi “Mocioni i Idriz Balajt Kundër Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të rishikuar”; dhe Lahi Brahimaj dorëzoi “Përgjigje në emër të Lahi Brahimajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për Aktakuzën” (së bashku “Parashtrime të Mbrojtjes për Aktakuzën e shkurtuar”). Më 7 dhjetor 2010 Prokuroria dorëzoi “Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes për Versionin e Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar”.

5. Në “Vendim mbi Mocionin për Zgjatje Afati për Dorëzimin e Dosjes Paragjyqësore, Listën e Provave Materiale dhe Listën e Dëshmitarëve” lëshuar më 29 nëntor 2010, Dhoma Gjyqësore zgjati afatin e dorëzimit prej Prokurorisë të Dosjes Paragjyqësore, listës së dëshmitarëve dhe provave materiale bazuar në Rregullën 65 *ter*, deri më 3 dhjetor 2010. Në atë datë Prokuroria dorëzoi “Parashtrim i Prokurorisë Bazuar në Rregullën 65 *ter* (E)”, ku përfshiheshin Dosja Paragjyqësore, Lista e Dëshmitarëve e Rregullës 65 *ter* dhe Lista e Provave Materiale e Rregullës 65 *ter*.

6. Më 10 dhjetor 2010, Prokuroria dorëzoi konfidencialisht “Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Mocioneve të Mbrojtjes për Zgjatje Afati dhe ndaj Mocionit të Haradinajt për Përcaktimin e Kuadrit të Rigjykimit (“Përgjigje Përmbledhëse”).

7. Më 13 dhjetor 2010 Balaj dorëzoi konfidencialisht “Kërkesë e Idriz Balajt për Leje për Kundërpërgjigje dhe Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Mocioneve të Mbrojtjes për Zgjatje Afati për Dorëzimin e Dosjeve Paragjyqësore të Mbrojtjes” (“Kundërpërgjigje e Balajt”) dhe Haradinaj dorëzoi konfidencialisht “Kundërpërgjigje në Emër të Ramush Haradinajt ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Mocioneve të Mbrojtjes për Zgjatje Afati dhe ndaj Mocionit të Haradinajt për Përcaktimin e Kuadrit të Rigjykimit” (“Kundërpërgjigje e Haradinajt”).

B. PARASHTRIMET

1. Mocionet e Mbrojtjes për Zgjatje Afati

8. Balaj parashtron se ai nuk mund ta dorëzojë Dosjen e tij Paragjyqësore brenda 14 dhjetorit 2010 me arsyetimin se ende nuk është vendosur në lidhje me apelet kundër lëndës së Aktakuzës së shkurtuar⁶ dhe se kohët e fundit atij i kanë treguar informacion të paplotë për dëshmitarët që Prokuroria synon të paraqesë.⁷ Ai argumenton se kundërshtimet apo mospajtimet e tjera në lidhje me aktakuzën duhen zgjidhur para se Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë të mund të parashtrojë besueshmërisht karakterin dhe elementët e akuzave dhe para se Mbrojtja të paraqesë një përgjigje të bazuar në informacion dhe të arsyetuar.⁸ Balaj kërkon që të shfuqizohet data ekzistuese për dorëzimin e Dosjes së tij Paragjyqësore dhe data e re të caktohet pas zgjidhjes së kundërshtimeve ndaj Aktakuzës së shkurtuar.⁹

9. Haradinaj argumenton se zgjatja e afatit të dorëzimit të Dosjes Paragjyqësore diktohet prej arsyeve të mëposhtme

- (a) Nuk janë përcaktuar ende as forma e Aktakuzës, as kuadri i lejueshëm i rigjykimit të pjesshëm;¹⁰
- (b) Më 3 dhjetor 2010 Prokuroria identifikoi për herë të parë gjashtë dëshmitarë të rinj të cilët synon ti paraqesë në rigjykimin e pjesshëm;¹¹
- (c) Ai i kundërshton këto prova për disa arsye dhe kundërshtimet mund të zgjidhen vetëm duke u bazuar në një interpretim të duhur të urdhrit të Dhomës së Apelit;¹²
- (d) Ai nuk është në gjendje të hetojë provat e reja me qëllim që të përgatisë mbrojtjen e tij në Dosjen Paragjyqësore brenda 14 dhjetorit 2010;¹³ dhe

⁶ Mocion i Balajt për Zgjatje Afati, para 8-9.

⁷ Po aty, para 10-14.

⁸ Po aty, para 9.

⁹ Po aty, para 15.

¹⁰ Mocion i Haradinajt për Zgjatje Afati, para 2(i).

¹¹ Po aty, para 2(ii).

¹² Po aty, para 2(iii). Shih po aty., para 8.

¹³ Po aty, para 2(iv). Shih po aty., para 13, 17.

- (e) Atij i nevojitet kohë të studiojë aktekspertizën e një eksperti për të cilin Prokuroria informoi më 3 dhjetor 2010, se do ta paraqesë për herë të parë.¹⁴

10. Haradinaj kërkon që të shtyhet data e dorëzimit të Dosjes së tij Paragjyqësore dhe të zëvendësohet prej një urdhri që ajo të dorëzohet brenda 14 ditësh pas vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi formën e Aktakuzës dhe kuadrin e lejueshëm të rigjykit të pjesshëm,¹⁵ dhe sido që të jetë, jo më herët se 14 janar 2011.¹⁶

11. Brahimaj parashtroi se ai është i privuar prej një pjese të konsiderueshme e thelbësore të provave të reja të cilat Prokuroria deklaroi se do të paraqesë në rigjykimin e pjesshëm.¹⁷ Ai argumenton se problemet e ngritura në “Përgjigje në emër të Lahi Brahimajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për Aktakuzën” duhen zgjidhur para afatit të dorëzimit të Dosjes së tij Paragjyqësore. Ai kërkon që data ekzistuese e caktuar për dorëzimin e Dosjes së tij Paragjyqësore të shfuqizohet dhe data e re të caktohet pas zgjidhjes së kundërshtimeve kundrejt Aktakuzës së shkurtuar.¹⁸

2. Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocioneve të Mbrojtjes për Zgjatje Afati

12. Prokuroria argumenton se të Akuzuarit nuk kanë mundur të tregojnë arsye bindëse për zgjatjen e afatit të dorëzimit të Dosjeve Paragjyqësore me më shumë se tri ditë që u miratuan për Prokurorinë.¹⁹ Ajo parashtroi se mundësia e ndryshimit të aktakuzave nëpërmjet përfshirjes së akuzave të reja gjatë gjykit provon se kundërshtimet ndaj aktakuzës nuk janë pengesë për dorëzimin e Dosjeve Paragjyqësore të Mbrojtjes.²⁰ Prokuroria argumenton se në lidhje me kundërshtimet e të Akuzuarve kundrejt problemeve të përmendura në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë, ata mund ti bëjnë të njohura këto kundërshtime në Dosjet e tyre Paragjyqësore, dhe në qoftë se ndonjë nga këto kundërshtime kundër Aktakuzës së shkurtuar rezulton i suksesshëm, Dhoma Gjyqësore mund të urdhërojë palët të plotësojnë Dosjet e tyre Paragjyqësore sipas rastit.²¹

¹⁴ Po aty, para 2(v)

¹⁵ Kjo kërkohet në Mocionin e Haradinajt për Përcaktimin e Kuadrit.

¹⁶ Mocion i Haradinajt për Zgjatje Afati, para 12, 30.

¹⁷ Mocion i Brahimajt për Zgjatje Afati, para 4-5.

¹⁸ Mocion i Brahimajt për Zgjatje Afati, para 9.

¹⁹ Përgjigje Përmbledhëse, para 1.

²⁰ Po aty., para 4.

²¹ Po aty., para 4.

13. Në lidhje me pikat konkrete të përmendura në Mocionet e Mbrojtjes për Zgjatje Afati, Prokuroria parashtron:

- (a) Të Akuzuarve iu dhanë identiteti dhe deklaratat e paredaktuara të dy prej gjashtë dëshmitarëve të cilët më parë nuk njiheshin prej të Akuzuarve dhe kërkesa e Prokurorisë për vonesë në publikimin e identitetit të katër të tjerëve nuk është pengesë për dorëzimin e Dosjeve Paragjyqësore të Mbrojtjes;²²
- (b) Të Akuzuarve u është dhënë materiali i rregullave 65 *ter* (ii)(b) dhe 65 *ter* (ii)(c) për këta katër dëshmitarë;²³
- (c) Në lidhje me argumentin e Haradinajt për dëshmitarin ekspert të Prokurorisë, Rregulla 94bis nuk kërkon që pala kundërshtare të dorëzojë njoftimin para ose në të njëjtën kohë me Dosjen e vetë Paragjyqësore;²⁴

3. Kundërpërgjigje e Balajt

14. Balaj kërkon leje për Kundërpërgjigje.²⁵ Ai parashtron se kur Aktakuzës i shtohet një akuzë e re, rregullat parashohin dhe lejojnë apele kundër këtyre ndryshimeve dhe shtyrje të gjykimit nëse është e nevojshme²⁶ dhe se Prokuroria nuk ka paraqitur argumente bindëse se Dosjet Paragjyqësore duhen dorëzuar tani dhe jo pas përgjigjes ndaj apeleve kundër Aktakuzës.²⁷ Ai argumenton se pa zgjidhjen e kundërshtimeve ndaj Aktakuzës, ai nuk është në gjendje të dorëzojë Dosjen Paragjyqësore për arsye se ende mbetet e pazgjidhur çështja nëse do të lejohen ose nuk do të lejohen akuzat në lidhje me Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale.²⁸ Ai e kundërshton argumentin se në qoftë se apelet e tij miratohen, palët mund të korrigjojnë Dosjet e tyre Paragjyqësore, me arsyetimin se arsyeja e vetme logjike e asaj procedure nuk është veçse zgjidhja e çështjeve të mbetura në mënyrë të rregullt, kronologjike, duke shmangur gjasën e shpërdorimit të kohës dhe mjeteve.²⁹

²² *Po aty.*, para 5.

²³ *Po aty.*, para 5.

²⁴ *Po aty.*, para 5.

²⁵ Kundërpërgjigje e Balajt, para. 17.

²⁶ *Po aty.*, para 11.

²⁷ *Po aty.*, para 12.

²⁸ *Po aty.*, para 14.

²⁹ *Po aty.*, para 15-16.

4. Mocioni i Haradinajt mbi Përcaktimin e Kuadrit

15. Haradinaj parashtron se më 3 dhjetor 2010 për herë të parë Prokuroria identifikoi gjashtë dëshmitarë të rinj të cilët synon ti paraqesë në rigjykimin e pjesshëm dhe dha të dhëna jo të plota në lidhje me³⁰ ta dhe se Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë ka të bëjë me prova që dalin jashtë kuadrit të rigjykimit të pjesshëm.³¹ Sipas parashtrimit të Haradinajt, Dhoma Gjyqësore duhet të vendosë në lidhje me pranueshmërinë e dëshmive të dëshmitarëve të rinj para fillimit të rigjykimit të pjesshëm dhe para se atij ti kërkohet të dorëzojë Dosjen e tij Paragjyqësore.³²

16. Haradinaj kërkon që Dhoma Gjyqësore të urdhërojë urgjentisht që:

- (a) Palët të dorëzojnë parashtrime me shkrim në lidhje me kuadrin e rigjykimit të pjesshëm, pranueshmërinë e provave të reja në lidhje me pikat mbi Jabllanicën, dhe pranueshmërinë e provave në lidhje me pretendimet mbi incidentet që nuk përfshihen në pikat për Jabllanicën, brenda datës 17 dhjetor 2010, ose brenda datës që do të caktohet;
- (b) Të mbahet një seancë paraprake për të dëgjuar palët mbi këtë çështje;
- (c) Afati për dorëzimin e Dosjes Paragjyqësore të të Akuzuarit të shtyhet brenda 14 ditësh pasi Dhoma Gjyqësore të ketë vendosur në lidhje me këtë çështje;
- (d) Ndryshe, në rast se Dhoma Gjyqësore nuk nxjerr këto urdhra, data e dorëzimit të Dosjes Paragjyqësore të të Akuzuarit të shtyhet së paku deri më 14 janar 2011; dhe
- (e) Mbrojtja të lejohet të paraqesë parashtrime në lidhje me datën e gjykimit para se të përcaktohet, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për

³⁰ Mocion i Haradinajt mbi Përcaktimin e Kuadrit, para 2.

³¹ Po aty., para 3.

³² Po aty., para 5.

përgatitjen e efektshme dhe të drejtë të mbrojtjes për rigjykimin e pjesshëm.³³

5. Përgjigje ndaj Mocionit të Haradinajt mbi Përcaktimin e Kuadrit në Përgjigjen
Përmbledhëse

17. Prokuroria gjykon se kërkesa e Haradinajt për parashtrime mbi kuadrin e rigjykimit të pjesshëm dhe pranueshmërinë e provave është e parakohshme.³⁴ Prokuroria parashtron se në qoftë se Haradinaj nuk pajtohet me qëndrimin e Prokurorisë se ndër dëshmitarët në rigjykim të pjesshëm nuk do të jenë vetëm Shefqet Kabashi dhe dëshmitari tjetër i përmendur prej Dhomës së Apelit, ai duhet ta apelojë këtë vendim.³⁵ Ajo argumenton se e vetmja arsye e paraqitur nga Haradinaj për përcaktimin e kuadrit të rigjykimit të pjesshëm para se ai të dorëzojë Dosjen e tij Paragjyqësore, është nevoja e kryerjes së hetimeve në lidhje me dëshmitarët e rinj dhe se nuk është kusht që këto hetime të përfundojnë para dorëzimit të Dosjes së tij Paragjyqësore.³⁶ Gjithashtu Prokuroria se vendimi për pranueshmërinë e provave normalisht bën pjesë në procesin e gjykitimit dhe sido që të jetë nuk duhet marrë vendim para dorëzimit të Dosjeve Paragjyqësore të Mbrojtjes.³⁷

6. Kundërpërgjigje e Haradinajt

18. Haradinaj kërkon leje për kundërpërgjigje³⁸ dhe kërkon që Dhoma Gjyqësore të rrëzojë Përgjigjen Përmbledhëse dhe të nxjerrë urdhrat e kërkuar në Mocionin e Haradinajt për Zgjatje Afati dhe Mocionin e Haradinajt mbi Përcaktimin e Kuadrit.³⁹ Haradinaj parashtron se vendimet procedurale në *Prokurori k. Muvunyi* në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ruandën, vlejné si mbështetje e drejtpërdrejte e kërkesës së tij për përcaktimin e kuadrit të rigjykimit para fillimit të tij⁴⁰ dhe se procedura në këtë çështje

³³ Po aty., para 20.

³⁴ Përgjigje Përmbledhëse, para 8-12.

³⁵ Po aty., para 9.

³⁶ Po aty., para 10.

³⁷ Po aty., para 12.

³⁸ Kundërpërgjigje e Haradinajt, para 1.

³⁹ Po aty., para 8.

⁴⁰ Po aty., para 2.

gjithashtu shkon në dobi të kërkesës së tij që kuadri i rigjykimit të përcaktohet para se procedimi i çështjes të shkojë më tej në mënyrë të rregullt ose të përshtatshme.⁴¹

C. DISKUTIM

19. Në Parashtrimet e Mbrojtjes mbi Aktakuzën e shkurtuar secili i Akuzuari kundërshton mënyrën e parashtrimit të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale.⁴² Gjithashtu Brahimaj kundërshton përfshirjen e pikave 3 dhe 5 kundër tij.⁴³ Në “Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes mbi Versionin e Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt”, Prokuroria i kundërshton këto parashtrime. Dhoma Gjyqësore ende nuk ka vendosur për problemet e ngritura. Në qoftë se Dhoma Gjyqësore do të pranonte parashtrimet e të Akuzuarve, atëherë do të lindte nevoja për korrigjime të konsiderueshme të Aktakuzës së shkurtuar

1. Kërkesat për Zgjatje Afati të Dorëzimit të Dosjeve Paragjyqësore

20. Kuadri i gjykimit në çështjen aktuale është unik për arsye se është skicuar konkretisht dhe deri diku në hollësi në Aktgjykimin e Dhomës së Apelit. Për më tepër, ekzistojnë mospajtime materiale midis palëve në lidhje me kuadrin e rigjykimit të pjesshëm që u urdhërua në atë Aktgjykim. Në këto rrethana, Dhoma Gjyqësore gjykon se për hir të efektshmërisë së procesit dhe qartësisë së çështjeve, duhet të përcaktohet versioni autoritativ i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt që korrespondon me lëndën e rigjykimit të pjesshëm, para se Mbrojtja të vendosë në lidhje me çështjen e saj. Ky vendim mund të diktojë rishikim të Dosjes Paragjyqësore të Prokurorisë⁴⁴ si dhe të Aktakuzës së shkurtuar. Dhoma Gjyqësore konkludon se të Akuzuarit ende nuk kanë detyrim të dorëzojnë Dosjet e tyre Paragjyqësore, dhe këtë duhet ta bëjnë në bazë të një urdhri të ri që do të lëshojë Dhoma Gjyqësore jo më parë se vendimi i saj mbi Parashtrimet e Mbrojtjes për Aktakuzën e shkurtuar.

⁴¹ *Po aty.*, para 4.

⁴² Parashtrim në Emër të Ramush Haradinajt mbi Versionin e ri të Aktakuzës për Rigjykim të Pjesshëm, 23 nëntor 2010, para 4-17; Mocion i Idriz Balajt Kundër Versionit të ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të rishikuar, 23 nëntor 2010, para 12-29; Përgjigje në emër të Lahi Brahimajt Ndaj Mocionit të Prokurorisë për Aktakuzën, 23 nëntor 2010, para 43-63.

⁴³ Përgjigje në emër të Lahi Brahimajt Ndaj Mocionit të Prokurorisë për Aktakuzën, 23 nëntor 2010, para 14-39.

⁴⁴ *Shih Prokurori k. Tolimirit*, Lënda Nr. IT-05-88/2-PT, Vendim mbi Mocionin Paraprak të të Akuzuarit Bazuar në Rregullën 72(A)(ii), 10 shkurt 2010, para 17, 18.

2. Kërkesa e Haradinajt Në Lidhje me Përcaktimin e Kuadrit të Aktakuzës

21. Dhoma Gjyqësore pajtohet me argumentin e Prokurorisë se përcaktimi i pranueshmërisë së provave normalisht është aspekt i gjykimit dhe nuk është e nevojshme që në lidhje me to të vendoset para dorëzimit të Dosjeve Paragjyqësore të Mbrojtjes.⁴⁵ Nuk ekziston një rregullore procedure që të kërkojë që problemi i pranueshmërisë së dëshmive të dëshmitarëve të propozuar nga Prokuroria të zgjidhet para dorëzimit të Dosjeve Paragjyqësore prej të Akuzuarve. Gjithashtu derisa Dhoma Gjyqësore të ketë vendosur në lidhje me Parashtrimet e Mbrojtjes për Aktakuzën e shkurtuar, kuadri i saktë i argumentit të Prokurorisë dhe rrjedhimisht identiteti i dëshmitarëve që mund të paraqesë, mbetet i paqartë. Parashtrimet e Mbrojtjes për Aktakuzën e shkurtuar kanë të bëjnë me kuadrin e aktakuzës dhe rrjedhimisht me kuadrin e rigjykimit të pjesshëm. Si pasojë në këtë fazë të procesit nuk nevojiten parashtrime të tjera mbi kuadrin e rigjykimit të pjesshëm përse i përket pranueshmërisë së provave.

22. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma Gjyqësore nuk e pranon argumentin e Haradinajt se afati për dorëzimin e Dosjes së tij Paragjyqësore duhet zgjatuar deri 14 ditë pas vendimit mbi pranueshmërinë e dëshmive të dëshmitarëve që ai identifikon dhe kuadrin e rigjykimit të pjesshëm, dhe nuk pranon që në këtë fazë do të ishte e përshtatshme mbajtja e një seance paraprake për ti dëgjuar palët mbi këtë çështje.⁴⁶ Në të njëjtën mënyrë Dhoma Gjyqësore gjykon se i Akuzuari mund të paraqesë peticione kundër pranueshmërisë së dëshmive të dëshmitarëve paraqitur nga Prokuroria në kohën e duhur.

23. Dhoma Gjyqësore pranon kërkesën e Haradinajt që të lejohet të bëjë parashtrime në lidhje me datën e gjykimit para se të caktohet.⁴⁷

D. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura dhe në përputhje me Rregullat 54, 65ter, 126bis dhe 127 Dhoma Gjyqësore:

⁴⁵ Përgjigje Përmbledhëse, para 12.

⁴⁶ Mocion i Haradinajt mbi Përcaktimin e Kuadrit, para 20(iii)

⁴⁷ Po aty., para 20(v).

LEJON Balajn dhe Haradinajn të paraqesin kundërpërgjigje;

MIRATON PJESËRISHT Mocionin e Mbrojtjes për Zgjatje Afati në aspektin që;

- a. **SHFUQIZON** urdhrin që të Akuzuarit të dorëzojnë Dosjet e tyre Paragjyqësore brenda datës 14 dhjetor 2010;
- b. **VENDOS** të nxjerrë një urdhër në lidhje me afatin e dorëzimit të Dosjeve Paragjyqësore të Mbrojtjes jo më herët se vendimi i saj mbi Parashtrimet e Mbrojtjes për Aktakuzën e shkurtuar; dhe;
- c. **RRËZON** Mocionet e Mbrojtjes për Zgjatje Afati në të gjitha aspektet e tjera; dhe

MIRATON PJESËRISHT Mocionin e Haradinajt mbi Përcaktimin e Kuadrit në aspektin që:

- a. **URDHËRON** që i Akuzuari të bëjë parashtrime mbi datën e gjykimit para se të përcaktohet; dhe
- b. **RRËZON** Mocionin e Haradinajt për të gjitha pikat e tjera.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 14 dhjetor 2010.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]